



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 04/L-041**

**PËR PRODHIMIN, GRUMBULLIMIN, PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN  
E DUHANIT**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR PRODHIMIN, GRUMBULLIMIN, PËRPUNIMIN DHE  
TREGTIMIN E DUHANIT**

**KREU I**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Me këtë ligj rregullohet prodhimi, grumbullimi, përpunimi, tregtimi i duhanit të pa përpunuar dhe produkteve të tij në Republikën e Kosovës.

## **Neni 2 Fushëveprimi**

Ky ligj rregullon marrëdhëniet juridike që kanë të bëjnë me procedurat, të drejtat dhe detyrat e subjekteve që merren me prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit.

## **Neni 3 Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Duhan** - gjethin e bimës së kultivuar nga lloji *Nicotiana tabacum* dhe *Nicotiana rustica*;

1.2. **Fermentim** - procesin biokimik të domosdoshëm për ta kthyer duhanin në produkt të gatshëm për pirje;

1.3. **Prodhimet e duhanit** - prodhimet e bëra vetëm nga duhani, të modifikuara apo të modifikuara gjenetikisht, apo pjesërisht nga duhani e që përdoren për të pirë, tërheq me hundë, thithë apo për typë;

1.4. **Përpunimi i duhanit dhe produkteve të tij** - teknologjia nëpër të cilin kalon duhani;

1.5. **Përpunimi industrial** - klasifikimi, manipulimi, heqja e kërcellit, fermentimi dhe përgatitja e duhanit për tregtim;

1.6. **Paketim** - ambalazhimi i duhanit dhe prodhimeve të tij me qëllim të vendosjes në treg për shitje;

1.7. **Tregtimi** - shitja me pakicë dhe shumicë, eksportin dhe importin e prodhimeve të duhanit dhe produkteve të tij;

1.8. **Vargu** - një sasi të duhanit të pa fermentuar dhe të pa përpunuar;

1.9. **Tuba** - bashkimi i dy apo më shumë vargjeve të duhanit;

1.10. **Dengu** - bashkimi i dy apo më shumë tubave të duhanit;

1.11. **Furra** - vendi ku bëhet terja e duhanit *Virxhinia* dhe llojet tjera.

1.12. **Grumbulluesi i duhanit** - pranimin e duhanit të pa fermentuar në vendet e grumbullimit, vendosjen, dhe ruajtjen për përpunim të mëtutjeshëm;

1.13. **Cigare** – duhani i mbështjellur me gjatësi standarde, duke mos llogaritur filtrin;

1.14. **Pure** - mbështjellëse nga duhani e cila është e dedikuar për pirje me mbështjellës të brendshme ose të jashtme të punuara nga duhani natyral për pirje;

1.15. **Etiketa** - përmbajtje e shkruar, e shtypur, e gdhendur e deklarimit e cila i bashkëngjitet një malli”;

1.16. **Duhani për pirje** - duhani i grirë pas përpunimit industrial që dedikohet për pirje;

1.17. **Katran** - mbetja e thatë të tymit të duhanit pa nikotinë;

1.18. **Nikotinë** - alkaloidi i cili gjendet në duhan dhe ka veprim helmues në sistemin nervor autonom;

1.19. **Monoksid karboni** - gazi toksik që është pjesë përbërëse e tymit të duhanit;

1.20. **Subjekt-et** - personi fizik apo juridik, të cilët merren me prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit;

1.21. **Banderola** - pulla fiskale që i ngjitet çdo njësie të zakonshme të prodhimeve të duhanit, si dëshmi e pagesës së akcizës;

1.22. **MBPZHR** - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

1.23. **AUV** - Agjencia për Ushqim dhe Veterinari;

1.24. **MTI** - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;

1.25. **MF** - Ministria e Financave.

## **KREU II PRODHIMI I DUHANIT**

### **Neni 4 Regjistrimi dhe licencimi**

1. Të gjithë prodhuesit e duhanit, duhet të regjistrohen në regjistrin zyrtar të MBPZHR-së.
2. Të gjithë grumbulluesit dhe përpunuesit industrial të duhanit, duhet të licencohen në MBPZHR-së.

3. Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e dhënies së licencës nga paragrafi 2 i këtij neni e përcakton me akt nënligjor MBPZHR.

### **Neni 5 Lidhja e kontratës**

1. Subjektet me rastin e lidhjes së kontratës në formë të shkruar për prodhimin dhe grumbullimin e duhanit me koperuesit, prodhuesit, obligohen që të paraqesin prodhimin e planifikuar të duhanit të vitit prodhues më së voni deri më 31 mars të vitit vijues në MBPZHR.

2. Subjekteve nga paragrafi 1. i këtij neni MBPZHR-ja i lëshon licencë për të gjitha ngastrat e verifikuara nga inspektorët fitosanitar ku prodhohet duhani.

3. Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e dhënies së licencës nga paragrafi 2. i këtij neni MBPZHR e përcakton me akt nënligjor.

### **Neni 6 Farërat dhe materiali fidanor**

Farërat dhe materiali fidanor i duhanit shpërndahet nga subjektet pas dëshmimit me certifikatën fitosanitare dhe dokumenteve përcjellëse.

### **Neni 7 Prodhimi i farës së certifikuar**

Për prodhimin e fidanëve të duhanit, përdorën vetëm farërat që janë prodhuar dhe certifikuar në pajtim me legjislacionin në fuqi për prodhimin e farërave bujqësore të vendit dhe të vendeve të jashtme.

### **Neni 8 Deklarimi**

1. Prodhuesit e duhanit, në fillim të vitit, deri më 30 qershor, bëjnë deklarimin me shkrim, në MBPZHR-së, me të dhënat faktike për vendin e prodhimit, sipërfaqen, tipin, llojin, klasën dhe prodhimin e planifikuar të duhanit.

2. Regjistri i prodhuesve të duhanit dhe i sipërfaqeve të kultivuara me këtë kulturë mbahet në MBPZHR.

3. Prodhuesit regjistrojnë tipet dhe klasën e duhanit në regjistrin e MBPZHR-së.

4. Tipin, llojin, klasën dhe kriteret për vlerësimin e duhanit, përmbajtja dhe puna e Komisioneve profesionale, përcaktohet me akt nënligjor nga MBPZHR.

### **KREU III**

#### **KONTRATA PËR PRODHIMIN DHE GRUMBULLIMIN E DUHANIT**

##### **Neni 9**

##### **Forma e kontratës**

1. Për prodhimin e duhanit, prodhuesi lidh kontratë me shkrim me grumbulluesin, ose përpunuesin e duhanit.
2. Për prodhimin dhe grumbullimin e duhanit brenda një sezone, prodhuesi për të njëjtin prodhim, nuk mund të lidh kontratë me më tepër se një grumbullues të licencuar nga MBPZHR-së.
3. Grumbulluesi nuk mund të lidh kontratë për sasi të duhanit, për të cilat prodhuesi ka lidhur kontratë me grumbulluesin tjetër brenda një sezone prodhuese për të njëjtin prodhim.

##### **Neni 10**

##### **Regjistrimi**

Çdo grumbullues i duhanit, duhet të vërtetohet me vulë sasinë e kontraktuar dhe numrin e kontratës në regjistrin e vërtetuar të prodhuesit të duhanit.

##### **Neni 11**

##### **Të dhënat**

Të dhënat për duhanin e grumbulluar, në sasi dhe cilësi, deklarohen nga grumbulluesi dhe regjistrohen në regjistrin e MBPZHR-së.

## **KREU IV PËRPUNIMI INDUSTRIAL I DUHANIT DHE PRODUKTEVE TË TIJ**

### **Neni 12 Përpunimi industrial**

1. Përpunimi industrial i duhanit, deri në finalizim kryhet nga subjektet, vendor dhe të huaj, të pajisur me licencë përpunimi nga MBPZHR-ja.
2. Licenca nga paragrafi 1. i këtij neni u jepet subjekteve, vendor dhe të huaj, që i plotësojnë kushtet teknike dhe teknologjike për përpunimin industrial të duhanit dhe produkteve të tij.
3. Kriteret, mënyra dhe forma e dhënies së licencës nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni përcaktohen me akt nënligjor nga MBPZHR-së.

## **KREU V TREGTIMI I DUHANIT**

### **Neni 13 Duhani dhe produktet e duhanit**

Duhani dhe produktet e duhanit të fermentuar të grirë tregtohen të pakeluar varësisht nga specifikat e tipit të produktit të tij.

### **Neni 14 Tregtimi i duhanit të tharë**

1. Prodhuesi tregon duhanin e tharë të përgatitur në vargje – dengje dhe produkteve tjera si dhe duhanin e freskët të tipit virgjinia.
2. Ndalohet eksporti i duhanit të pa fermentuar dhe të pa përpunuar.

### **Neni 15 Etiketa**

1. Produktet e duhanit për qarkullim në tregun e Kosovës, duhet të përmbajnë etiketën me të dhënat për përmbajtjen e katranit, nikotinës dhe monoksidit të karbonit të përcaktuara sipas Ligjit Nr.02/L-36 për duhan dhe standardeve të Bashkësisë Evropiane.
2. Produktet e duhanit të cilat importohen nga vende anëtare të BE-së, mund të përmbajnë të shënuar ose emrin dhe adresën e prodhuesit, ose emrin e prodhuesit dhe shënimin “prodhuar në

BE”. Importuesi i produkteve të duhanit sipas këtij paragrafi nuk përjashtohet nga detyrimi për të paraqitur pranë MTI deklaronin e saktë të produkteve të importuara, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit.

3. Produktet nga paragrafi 1. i këtij neni, duhet të përmbajnë banderolën e ngjitur në vendin e dukshëm në ambalazhin në brendi të paketimit të tejudkshëm dhe të përmbajnë të dhëna në përputhje me Ligjin për duhanin.

## **KREU VI**

### **NDALIMI I TREGTIMIT TE DUHANIT DHE PRODUKTEVE TË TIJ**

#### **Neni 16**

##### **Ndalimi**

1. Ndalohet tregtimi i duhanit dhe i produkteve të tij në treg, nëse:

- 1.1. kryhet nga subjektet e pa licencuar;
- 1.2. duhani apo produktet e tij me defekte ulin cilësinë përdoruese;
- 1.3. duhani është i grirë por i pa paketuar;
- 1.4. nuk ka etiketën dhe nuk kanë të dhëna, si përcaktohen në Ligjin për Duhanin.

## **KREU VII**

### **LICENCIMI I SUBJEKTEVE QË TREGTOJNË DUHANIN DHE PRODUKTET E TIJ**

#### **Neni 17**

##### **Licencimi**

1. Subjektet që merren me tregtimin e duhanit dhe produkteve të tij pajisen me licencën përkatëse për ushtrimin e këtij aktiviteti nga MTI.

2. Asnjë subjekt, vendor apo i huaj nuk mund të tregtoje duhanin apo produktet e tij pa u pajisur me licencën përkatëse.

3. Subjektet që zhvillojnë aktivitete tregtare, pasi të jenë të regjistruar në MTI sipas këtij ligji, duhet të aplikojnë për lejen e importit të duhanit dhe produkteve të tij në AUV.

4. Kriteret dhe kushtet për dhënien e licencës së subjekteve që zhvillojnë aktivitete të biznesit nga paragrafi 3. i këtij neni rregullohen me akt nënligjor nga MTI.

### **Neni 18** **Ndalimi i veprimtarisë**

1. Kur subjekti nuk i përmbahet zbatimit të dispozitave procedurale të këtij ligji, mund ti merret licenca për tregtimin dhe prodhimin e duhanit nga MTI.
2. Nëse subjekti dënohet për kontrabandë me tregtimin e duhanit dhe prodhimeve të tij, MTI i merr licencën dhe ndalon përherë aktivitetin për import dhe eksport të prodhimeve të duhanit.
3. Nëse subjekti nga paragrafi 1. i këtij neni është recidivist, mund ti ndalohet ushtrimi i kësaj veprimtarie.

## **KREU VIII** **SHITJA ME PAKICË**

### **Neni 19** **Vendet për shitje për pakicë**

1. Shitja me pakicë ushtrohet në vende të caktuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Ndalohet dhe sanksionohet shitja e duhanit nga të miturit dhe për të mitur.

### **Neni 20** **Përcaktimi i çmimeve**

Çmimet e shitjes me pakicë të produkteve të duhanit, që shiten në treg, përcaktohen në pajtim me parimet e tregut të lirë.

### **Neni 21** **Regjistrimi i markës tregtare dhe deklaracioni i mallit**

1. Produktet e duhanit që prodhohen dhe tregtohen në Kosovë, mund ta mbrojnë markën tregtare sipas Ligji Nr.02/L-54 për Markat Tregtare.
2. Në produktet e prodhuara dhe tregtuara të duhanit në Kosovë, duhet të vendoset etiketa e mallit në të cilin prodhuesi, importuesi, distributori dhe shitësi obligohet t'i siguroi konsumatorit të dhënat përkatëse për atë mall.



3. Produktet e duhanit qe prodhohen në Kosove, duhet të jenë të shoqëruara me deklaratën e mallit e cila përmban: Emrin e mallit, llojin, origjinën, importuesin, eksportuesin, distributorin, njësia matëse, data e prodhimit dhe adresa, selia dhe numri i telefonit të prodhuesit, importuesit, eksportuesit dhe distributorit.

## **Neni 22 Dokumentacioni**

1. Produktet e duhanit nga neni 21 paragrafi 3. i këtij ligji, kur transportohen nëpër hapësirat doganore të Kosovës, duhet të jenë të shoqëruara me dokumente përkatëse doganore si dhe dokumente tjera nga të cilat shihet se ato produkte janë të parapara për eksport dhe me dokumente prej nga janë marrë.
2. Në zonat doganore të Kosovës, në shitoret e lira doganore, në depot e furnizimit dhe në zonat e lira, nuk është e lejuar shitja e produkteve të duhanit, transporti i tyre pa dokumente prej nga janë marrë, përkatësisht të eksportohen, e as të blihen, nëse nuk janë të shënjuara me marka kontrolli.

## **Neni 23 Banderolat**

1. Prodhuesit e produkteve të duhanit janë të obliguar t'a paraqesin kërkesën me shkrim për shtypjen e banderolave pranë MF-ve.
2. Vendosja pa autorizim apo falsifikimi i banderolës konsiderohet vepër penale dhe sanksionohet sipas legjislacionit në fuqi.

## **Neni 24 Garancitë bankare**

Prodhuesit, eksportuesit dhe importuesit, eksportuesit e produkteve të duhanit të cilët i marrin për herë të parë banderolat janë të obliguar ta japin garancinë bankare apo ndonjë instrument tjetër me të cilin sigurohet pagesa e të gjitha obligimeve fiskale për produktet e duhanit.

## **Neni 25 Evidentimi**

1. Subjektet të cilët prodhojnë, grumbullojnë, eksportojnë, importojnë dhe tregtojnë produkte të duhani janë të obliguar të mbajnë evidenca ditore për prodhimin, qarkullimin dhe gjendjen e tyre.

2. Në faturë për produktet e duhanit të parapara për eksport, duhet shënuar numrin dhe datën e lejes për eksport.

### **Neni 26 Raportet**

1. Importuesit janë të obliguar t'i hartojnë dhe t'ia paraqesin MF-ve raportet mujore dhe vjetore për importimin, eksportimin e produkteve të duhanit, për stoqet në depot doganore, shitjen në shitoret e lira doganore, depot e furnizimit dhe zonat e lira si dhe për shitjet brenda vendit.

2. Subjektet afariste, deri në fund të muajit për muajin paraprak, duhet t'ia paraqesin MF-ve raportin me kopjet e dokumenteve të eksportit, nga të cilat shihet se në cilin pikë të vendkalim kufitar produktet e duhanit kanë dalë nga Kosova.

### **Neni 27 Reklamimi**

Ndalohet reklamimi dhe promovimi publik i çdo forme të tregtimit të duhanit dhe prodhimeve të tij.

### **Neni 28 Mbikëqyrja**

Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të tij, bëhet përmes Inspekcionit fitosanitar, dhe Inspektoratit të tregut sipas legjislacionit në fuqi.

### **Neni 29 Inspekcioni fitosanitar**

1. Inspeksioni fitosanitar merr Vendim me të cilin e ndalon prodhimin dhe qarkullimin e duhanit nëse:

1.1. konstaton se grumbulluesi para se të lidh kontratë për prodhim nuk e paraqet prodhimin e duhanit të vitit prodhues në MBPZHR sipas nenit 4 të këtij ligji;

1.2. prodhuesi i duhanit nuk përdor farërat që janë prodhuar dhe certifikuar sipas legjislacionit në fuqi për prodhimin e farërave bujqësore sipas nenit 6 të këtij ligji;

1.3. konstaton se prodhuesi i duhanit bënë prodhimin e duhanit pa lidhur kontratë për prodhimin dhe grumbullimin e duhanit me grumbulluesin sipas nenit 9 të këtij ligji;

1.4. grumbulluesi i duhanit nuk e deklaron sasinë dhe vlerën e tij sipas regjistrit të regjistruar në MBPZHR sipas nenit 11 të këtij ligji.

1.5. përpunimi industrial dhe grumbullim i duhanit kryhet nga subjektet të pa licencuara sipas nenit 12 të këtij ligji.

### **Neni 30** **Inspektori i tregut**

1. Inspektorati i tregut merr vendim për ndalimin e tregtimit të produkteve të duhanit nëse:

1.1. janë në tregun e Kosovës dhe nuk e posedojnë etiketën për përmbajtjen e duhanit në bazë të nenit 15 të këtij ligji;

1.2. subjektet që merren me tregtimin e duhanit dhe produkteve të tij që nuk janë të pajisur me licencë për ushtrimin e kësaj veprimtarie sipas nenit 17 të këtij ligji;

1.3. produktet e duhanit që prodhohen dhe tregtohen, nuk i posedojnë të dhënat për markën tregtare sipas nenit 21 të këtij ligji.

### **Neni 31** **Qasja e inspektorit në dokumentacion**

Prodhuesit, grumbulluesit, përpunuesit dhe tregtuesit e duhanit dhe produkteve të tyre kanë për detyrë që inspektorit përkatës ti mundësojnë kryerjen e detyrës dhe ti ofrojnë të dhënat dhe informatat e nevojshme si dhe qasje të lirë në regjistrat dhe dokumentacion relevant.

### **Neni 32** **Ankesa**

1. Kundër vendimit të inspektorit nga neni 29 dhe 30 të këtij ligji, mund të paraqitet ankesë me shkrim udhëheqësit të inspektoratit përkatës, në afat prej pesëmbëdhjetë pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

2. Përgjigjja në ankesën e paraqitur nga paragrafi 1. i këtij neni, duhet të jepet me shkrim në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

3. Kundër vendimit të udhëheqësit të inspektorit përkatës, pala mund të paraqes padi në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

## **KREU IX DISPOZITAT NDËSHKIMORE**

### **Neni 33 Kundërvajtjet**

1. Me gjobë prej tremijë (3.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro dënohet për kundërvajtje subjekti fizik përkatësisht juridik, nëse:

1.1. nuk e përdorë fidanët-farërat që janë prodhuar dhe certifikuar sipas legjislacionit në fuqi për prodhimin e farërave bujqësore të vendit dhe nuk janë të regjistruara sipas nenit 6 të këtij ligji;

1.2. të dhënat për duhanin e tregtuar në sasi dhe cilësi nuk janë deklaruar nga grumbulluesi dhe nuk janë të regjistruar në regjistrin e MBPZHR-së sipas nenit 11 të këtij ligji;

1.3. nuk është i pajisur me licencë për tregtimin e duhanit dhe produkteve të tij sipas nenit 17 të këtij ligji;

1.4. vepron në kundërshtim me nenin 31 të këtij ligji.

2. Me gjobë prej treqind (300) deri në pesëqind (500) Euro për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni, dënohet edhe subjekti përgjegjës i personit juridik.

3. Me gjobë prej pesëqind (500) deri në pesëmijë (5.000) Euro për kundërvajtje dënohet personi fizik - juridik, nëse:

3.1. nuk është i regjistruar në regjistrin e duhanit të cilin e mbanë MBPZHR-ja sipas nenit 12 të këtij ligji;

3.2. nuk përmban etiketën me të dhënat për përmbajtjen e katranit dhe nikotinës sipas nenit 15 të këtij ligji;

3.3. subjektet nuk janë të pajisura me licencë dhe leje të importit apo eksportit të produkteve të duhanit sipas nenit 17 të këtij ligji.

3.4. produktet e duhanit që prodhohen dhe tregtohen nuk i posedojnë të dhënat për regjistrimin e markës tregtare, deklaracionin dhe shenjen e kontrollit sipas nenit 21 të këtij ligji.

4. Me gjobë prej dyqind (200) deri në pesëqind (500) Euro dënohet subjekti fizik dhe juridik, nëse:

4.1. nuk i paraqet në MBPZHR të dhënat faktike për vendin e prodhimit, sipërfaqen, llojin, tipin, dhe prodhimin e planifikuar të duhanit sipas nenit 8 të këtij ligji;

4.2. merret me prodhimin e duhanit pa lidhur kontratë për prodhimin dhe grumbullimin e duhanit me grumbulluesin sipas nenit 9 të këtij ligji;

4.3. nuk paraqet Raportet mujore dhe vjetore për importin dhe eksportin e produkteve të duhanit sipas nenit 26 të këtij ligji.

#### **Neni 34** **Masat mbrojtëse**

Përveç dënimit për kundërvajtje nga neni 33 i këtij ligji, subjektit mund ti shqiptohet masa mbrojtëse konfiskimi i duhanit dhe produkteve të tij që është përdorë për kryerjen e kundërvajtjes si dhe masa mbrojtëse për konfiskimin e pasurisë e cila është arritur si rezultat i kundërvajtjes.

#### **Neni 35** **Pagesat dhe të hyrat**

Të gjitha pagesat që rrjedhin nga zbatim i dispozitave ndëshkuese të këtij ligji si dhe të hyrat nga taksat, derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **KREU X** **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 36** **Zbatimi**

Për zbatimin e këtij ligji obligohet MBPZHR, dhe MTI për nxjerrjen e akteve nënligjore në afat prej dymbëdhjetë (12) muajve, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### **Neni 37** **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen dispozitat e Ligjit mbi duhanin (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.39/72) si dhe dispozitat e ligjeve të tjera që janë në kundërshtim me këtë ligj.

**Neni 38**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-041**  
**21 tetor 2011**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**